

NEWSLETTER

Tetor 2025

**Albsig mbyll me sukses
9-mujorin 2025.**

**Albsig vijon trajnimin mbi
Inteligjencën Artificiale.**

**Nga siguria te investimi: ALBSIG
mirëpret median në ambientet
moderne të Downtown One**

**ALBSIG në Samitin
Ekonomik Shqipëri–Turqi**

**Takimi i Brand Ambassadors të
Grupit Kastrati në ambientet e
ALBSIG**

**ALBSIG për Tetorin Rozë:
Zbulimi i hershëm shpëton jetë**



ALBSIG

PJESË E



KASTRATI GROUP



Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 31 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP



Albsig mbyll me sukses 9-mujorin 2025: Lider në tregun e sigurimeve me rezultate të qëndrueshme dhe performancë të lartë.

Shoqëria e Sigurimeve Albsig ka mbyllur me sukses periudhën Janar — Shtator 2025, duke konfirmuar edhe një herë pozitën e saj si një nga liderët e tregut të sigurimeve në vend. Bazuar në të dhënat zyrtare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Albsig renditet në krye të tregut për disa prej produkteve më të rëndësishme të sigurimeve jo—jetë, duke dëshmuar rritje, stabilitet dhe besueshmëri të qëndrueshme.

Lider në produktet kryesore të sigurimeve

Sipas raportit të AMF-së, Albsig renditet i pari në produktet Kasko duke zënë 37.31% të tregut, Përgjegjësi Ndërtuesi duke zënë 44.35% të tregut dhe Garanci duke zënë 51 % të tregut. Këto rezultate pasqyrojnë përkushtimin e vazhdueshëm të Albsig për të ofruar produkte sigurimi të personalizuar, të përshtatura me nevojat e klientëve individualë dhe atyre korporatë, si dhe për të mbajtur standardet më të larta të shërbimit dhe transparencës në treg.

Rritje e qëndrueshme në produktet vullnetare

Albsig vijon të qëndrojë ndër shoqëritë me përqindjen më të lartë të produkteve vullnetare, duke ruajtur raportin 52.22%, në një kohë kur mesatarja e tregut qëndron në 32.60%. Ky tregues nënvizon faktin se klientët zgjedhin Albsig jo vetëm për detyrimet ligjore të sigurimit, por për besimin dhe cilësinë e produkteve vullnetare që kompania ofron, një reflektim i drejtëpërdrejtë i angazhimit për inovacion dhe kujdes ndaj klientit.

Performancë e lartë në menaxhimin e dëmeve

Një tjetër element që e veçon Albsig në treg është efikasiteti në procesin e dëmshpërblimeve. Në datën 30 shtator 2025, Albsig regjistron numrin më të vogël të dëmeve pezull (të papaguara) në tregun e sigurimeve jo—jetë, me vetëm 388 dëme pezull, që përbëjnë vetëm 4.40% të totalit të tregut. Ky rezultat tregon qartë angazhimin për zgjidhjen e shpejtë dhe transparente të kërkesave për dëmshpërblim, si dhe menaxhimin e kujdesshëm financiar sipas kërkesave ligjore dhe standardeve ndërkombëtare.

Besim, përgjegjësi dhe profesionalizëm

Performanca e arritur në këtë 9-mujor reflekton punën e përkushtuar të gjithë stafit të Albsig dhe besimin që klientët tregojnë çdo ditë. Kompania vijon të mbetet e orientuar drejt rritjes së qëndrueshme, përmirësimit të përvojës së klientit, dhe zhvillimit të produkteve inovative që adresojnë nevojat reale të tregut shqiptar të sigurimeve.





Albsig vijon trajnimin mbi Inteligjencën Artificiale:

Puna në grup thellon përvetësimin e njohurive.


Në vijim të trajnimit të zhvilluar mbi Inteligjencën Artificiale mbajtur nga eksperti ndërkombëtar Josh Miekley, pjesa e dytë e aktivitetit u fokusua në punën në grup dhe ushtrime praktike, me synim përvetësimin konkret të njohurive të ndara gjatë sesionit teorik.

Gjatë kësaj faze, pjesëmarrësit, e punonjësit e Drejtorisë Qendrore, u angazhuan në situata reale pune, ku u inkurajuan të aplikojnë mjetet dhe teknikat e prezantuara për automatizimin e detyrave, krijimin e përmbajtjeve me efikasitet më të lartë dhe analizimin e të dhënave për vendimmarrje më të zgjuar.

Nëpërmjet ushtrimeve interaktive dhe diskutimeve bashkëpunuese, u nxit shkëmbimi i ideve dhe përvojave ndërmjet ekipeve, duke thelluar kuptimin mbi mënyrat se si inteligjenca artificiale mund të mbështesë proceset e përditshme të punës në sektorin e sigurimeve.



Puna në grupe solli zgjidhje kreative dhe shembuj konkretë të aplikimit të AI-së në fusha të ndryshme, si komunikimi me klientët, menaxhimi i informacionit dhe përmirësimi i përvojës digjitale të klientit.



Në përmbyllje, pjesëmarrësit ndanë reflektime mbi njohuritë e fituara dhe potencialin e teknologjisë për të transformuar mënyrën e punës në Albsig, duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe mësimit të vazhdueshëm.



Ky sesion praktik shënoi një hap tjetër konkret në drejtim të zhvillimit profesional dhe digjitalizimit të proceseve, duke përforcuar angazhimin e Albsig për të qenë një organizatë që përqafton inovacionin dhe e vendos teknologjinë në shërbim të njerëzve.



Nga siguria të investimi: Albsig mirëpret median në ambientet moderne të Downtown One.

ALBSIG, pjesë e Grupit Kastrati, mirëpriti përfaqësues të mediave në ambientet e reja në ndërtesën ikonike Downtown One, ku u zhvillua një konferencë për shtyp me drejtues të Albsig, Albsig Jetë dhe Albsig Invest, pasuar nga një tur ekskluziv i hapësirave moderne të kompanive. Ky aktivitet shënoi një moment të rëndësishëm për Albsig, duke reflektuar filozofinë e investimeve afatgjata, inovacionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në tregun shqiptar të sigurimeve dhe financave.

Qëndrueshmëri, besim dhe përkushtim.

Në fjalën e tij, Plarent Hamzaj, Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i ALBSIG, theksoi se qëndrueshmëria dhe besimi janë themelet mbi të cilat Shoqëria ka ndërtuar zhvillimin e saj ndër vite. Ai vuri në dukje se investimi i vazhdueshëm në inovacion, teknologji dhe përmirësimin e përvojës së klientit ka kthyer korrektësinë dhe transparencën në shtylla të pandashme të kulturës së punës së Albsig.

Hamzaj shtoi se vizioni i ALBSIG është të mbetet një partner afatgjatë dhe i besueshëm për klientët dhe institucionet financiare, duke kontribuar në forcimin e industrisë së sigurimeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tregut shqiptar. Sipas tij, vlera e një kompanie nuk matet vetëm me përmasën e saj, por me mënyrën se si ajo qëndron pranë klientëve në momentet vendimtare, një parim që e ka bërë Albsig një emër të respektuar për më shumë se dy dekada.

Lidership i konsoliduar në tregun e sigurimeve.

Në vijim, **Dritan Kastrati**, Zëvendësudrejtor i Përgjithshëm i ALBSIG, theksoi se rezultatet e kompanisë në trajtim dhe pagesë dëmsh janë dëshmi e qartë e korrektesisë dhe seriozitetit që e karakterizon. Prej më shumë se një dekade, Albsig renditet ndër liderët e tregut për shlyerjen e dëmeve, me mbi 150 mijë klientë të dëmshpërblyer, ndërsa vetëm në vitin e kaluar 17,157 klientë përfituan dëmshpërblimin e tyre.

Ai theksoi se Albsig mban numrin më të ulët të dëmeve pezull, vetëm 4% të totalit të tregut, si dhe numrin më të ulët të proceseve gjyqësore, çka dëshmon efikasitetin dhe transparencën e shoqërisë. Sipas tij, këta tregues janë rezultat i standardeve të larta të përgjegjshmërisë ndaj klientit, që kanë ndërtuar reputacionin e Albsig si një kompani me baza të forta financiare dhe besueshmëri të qëndrueshme në tregun shqiptar dhe rajonal.



ALBSIG Jetë — lider në tregun e sigurimeve të jetës.

Ervin Spahiu, Drejtor i Përgjithshëm i ALBSIG Jetë, theksoi se kompania ruan pozicionin lider në tregun e sigurimeve të jetës, falë një strategjie të qëndrueshme dhe partneriteteve të forta me institucionet financiare.

Ai nënvizoi se besimi i mijëra qytetarëve dhe partnerëve bankarë është rezultat i një ekipi të përkushtuar dhe i mbështetjes së vazhdueshme nga ALBSIG, që ka krijuar sinergji të forta midis kompanive të grupit.

Spahiu theksoi se ALBSIG Jetë do të vazhdojë të investojë në inovacion, cilësi dhe shërbim të personalizuar, duke ruajtur reputacionin e një kompanie që garanton siguri, stabilitet dhe besim afatgjatë.

Albsig Invest – ndërtim i qëndrueshëm i së ardhmes financiare.

Elton Korbi, Drejtor i Përgjithshëm i Albsig Invest, foli për rritjen e qëndrueshme të fondeve private të pensioneve dhe rëndësinë e tyre si mjet alternativ kursimi. Ai vuri në dukje se kompania po udhëheq tregun me kthime neto deri në 5.5% në vit për anëtarët dhe me koston më të ulët të administrimit prej vetëm 1.2% në vit.

Korbi theksoi se këto rezultate janë fryt i besimit të anëtarëve dhe bashkëpunimit me Albsig, i cili ka krijuar një bazë të fortë për zhvillimin e tregut të pensioneve private në Shqipëri.

Ai nënvizoi se edukimi financiar i publikut dhe zgjerimi i pjesëmarrjes në fondet e pensionit mbeten objektivat kryesore për ndërtimin e një të ardhme të qëndrueshme financiare.



Një vizion për të ardhmen.

Pas konferencës, përfaqësuesit e mediave morën pjesë në një tur të organizuar në ambientet e ALBSIG, ku u njohën nga afër me hapësirat bashkëkohore të punës, sallat e trajnimit dhe qendrat e komunikimit me klientët të Albsig, Albsig Jetë dhe Albsig Invest.

Ky investim, që përfaqëson besimin e Grupit Kastrati në potencialin e tregut shqiptar, tregon se standardet europiane janë tashmë një realitet që po ndërtohet çdo ditë në zemër të Tiranës.





MÜSIAD ALBANIA

ALBSIG në Samitin Ekonomik Shqipëri—Turqi:

Një hap i ri drejt forcimit të partneritetit strategjik dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Shoqëria e Sigurimeve ALBSIG mori pjesë në hapjen e Samitit Ekonomik Shqipëri—Turqi, organizuar nga MÜSIAD Albania, një aktivitet i rëndësishëm që vuri në qendër bashkëpunimin strategjik ndërmjet dy vendeve në fushat e turizmit, kulturës dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Ky forum shënon një tjetër hap përpara në forcimin e marrëdhënieve ekonomike mes Shqipërisë dhe Turqisë, duke krijuar mundësi të reja për investime, shkëmbime tregtare dhe bashkëpunime afatgjata, veçanërisht në sektorin e turizmit, një nga motorët kryesorë të zhvillimit të ekonomisë shqiptare.

Ura bashkëpunimi për zhvillim dhe inovacion.

Ngjarja mbledhi përfaqësues të bizneseve, institucioneve dhe qeverive nga të dy vendet, të cilët ndanë vizionin e përbashkët për forcimin e urave ekonomike dhe kulturore që lidhin Shqipërinë dhe Turqinë. Në qendër të diskutimeve u theksua rëndësia e partneriteteve të qëndrueshme, që nxisin zhvillimin ekonomik, turizmin cilësor dhe inovacionin në të dy tregjet.

B2B – Zemra e Forumit.

Një pjesë e rëndësishme e Samitit ishte Albania—Türkiye Investment Forum 2025, ku u zhvilluan takime B2B mes dhjetëra bizneseve shqiptare dhe turke. Këto takime krijuan hapësirën e duhur për shkëmbim idesh, ndërtim partneritetesh të reja dhe konkretizim projektesh të përbashkëta, duke e kthyer bashkëpunimin në veprim real.

Energjia pozitive, kontaktet e reja dhe iniciativat që morën jetë gjatë forumit treguan se e ardhmja e bashkëpunimit ekonomik mes Shqipërisë dhe Turqisë është më afër se kurrë.

Një vizion i përbashkët për zhvillimin rajonal.

Pjesëmarrja e ALBSIG në këtë samit përforcon angazhimin e shoqërisë për të qenë pjesë aktive e dialogut ekonomik rajonal, duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm dhe krijimin e mundësive të reja për investime.

Si pjesë e Grupit Kastrati, ALBSIG ndan të njëjtin vizion për bashkëpunim ndërkombëtar, inovacion dhe integrim ekonomik, duke kontribuar në forcimin e partneriteteve që sjellin vlerë të shtuar për bizneset dhe komunitetin.

Ky samit përfaqëson jo vetëm një platformë bashkëpunimi ekonomik, por edhe një urë miqësie dhe zhvillimi të qëndrueshëm midis dy vendeve që ndajnë histori, kulturë dhe vizion të përbashkët për të ardhmen.





Takimi i Brand Ambassadors të Grupit Kastrati në ambientet e ALBSIG.

Frymëzim, ide të reja dhe bashkëpunim – kështu rritemi çdo ditë.

Në ambientet moderne të ALBSIG, u zhvillua takimi i Brand Ambassadors të Grupit Kastrati, një nismë që bashkoi përfaqësues nga kompanitë anëtare të grupit për të ndarë ide, përvoja dhe vizione mbi komunikimin, inovacionin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të markës.

Ky aktivitet shërbeu si një hapësirë frymëzimi dhe bashkëpunimi, ku pjesëmarrësit ndanë praktikat më të mira dhe propozime konkrete për forcimin e identitetit të përbashkët të Grupit Kastrati në treg. Diskutimet u përqendruan në strategjitë e reja të komunikimit, përmirësimin e përvojës së klientit dhe promovimin e vlerave që bashkojnë të gjitha kompanitë e grupit: besimin, cilësinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Një rrjet bashkëpunimi që gjeneron rritje.

Takimi solli energji pozitive dhe ide kreative, duke reflektuar qartë filozofinë e Grupit Kastrati: rritja vjen përmes bashkëpunimit dhe ndarjes së njohurive. Në një atmosferë bashkëpunuese dhe dinamike, brand ambassadors u angazhuan në diskutime të hapura dhe ushtrime ndërvepruese që nxitën kreativitetin dhe mendimin strategjik. Ky takim forcon vizionin e grupit për të ndërtuar një komunitet profesional që mëson, frymëzohet dhe rritet së bashku.

Sepse në Grupin Kastrati, frymëzimi lind nga bashkëpunimi — dhe kështu rritemi çdo ditë.





ALBSIG për Tetorin Rozë.

 **Kujdes, ndërgjegjësim dhe mbështetje — sepse shëndeti fillon me kujdesin ndaj vetes.**

Në kuadër të Tetorit Rozë dhe si pjesë e traditës së përvitshme të ALBSIG, janë mundësuar kontrole falas për eko gjiri pranë Klinikës Wellness për të gjitha koleget e shoqërisë. Kjo nismë vjen si pjesë e angazhimit të ALBSIG për të mbështetur ndërgjegjësimin mbi parandalimin dhe diagnostikimin e hershëm të kancerit të gjirit, një kauzë me rëndësi të veçantë për komunitetin dhe shëndetin e grave.

Për ALBSIG, kujdesi ndaj shëndetit nuk është vetëm përgjegjësi personale, por një vlerë që përqafojmë së bashku. Kjo mundësi e ofruar për stafin tonë është shprehje e bindjes se parandalimi dhe kontrolli i rregullt janë hapat më të rëndësishëm drejt shëndetit dhe jetës së sigurt. Çdo vit, ALBSIG e përforcon këtë traditë si shenjë solidariteti, kujdesi dhe mbështetjeje, duke kujtuar se shëndeti i çdo gruaje është një prioritet që na bashkon të gjithëve.

Sepse në ALBSIG, kujdesi është pjesë e kulturës sonë — dhe çdo hap i vogël për shëndetin, është një hap i madh për jetën.



Zbulimi i hershëm shpëton jetë. Kujdesi ndaj vetes është fuqizim.

Tetori është muaji i ndërgjegjësimit për luftën kundër kancerit të gjirit, një kauzë që çdo vit na kujton rëndësinë e kujdesit, kontrollit dhe parandalimit.

Në kuadër të Tetorit Rozë, ALBSIG zhvillon një fushatë ndërgjegjësimi me moton: **“Në ndihmë të vajzave dhe grave për diagnostikimin sa më të hershëm të çdo problematike shëndetësore, me fokus në kancerin e gjirit.”** Ky muaj mbart një mesazh të fortë solidariteti dhe kujdesi, duke ftuar çdo vajzë e grua të marrë kohën për t’u informuar dhe për të bërë kontrollet periodike. Parandalimi dhe diagnostikimi i hershëm shpëtojnë jetë.

Në shenjë sensibilizimi dhe mbështetjeje, ALBSIG — pjesë e Kastrati Group — bashkohet edhe këtë vit me fushatën Tetori Rozë, duke qenë përkrah çdo gruaje në këtë betejë të rëndësishme për shëndetin dhe jetën. Sepse shëndeti është pasuria më e çmuar, dhe kujdesi për veten është hapi i parë drejt një të ardhmeje të sigurt.

Ne në ALBSIG besojmë se siguria nuk kufizohet vetëm te pasuritë dhe asetet materiale — ajo fillon nga shëndeti. Prandaj, ju inkurajojmë që gjatë këtij muaji të bëni kontrollin e gjirit dhe ta bëni këtë një pjesë të zakonshme të kujdesit tuaj personal.

Apeli i ALBSIG: Kujdesu për veten — sot



Kryej vetëkontroll një herë në muaj, zakonisht një javë pas menstruacioneve, për të vëzhguar çdo ndryshim në formë, ngjyrë apo ndjesi të gjirit.



Vizitohu tek mjeku specialist çdo vit. Për gratë mbi 40 vjeç, është e rëndësishme të kryhet mamografia çdo dy vjet — ose më shpesh, sipas rekomandimeve mjekësore.




Mos e shtyni kontrollin. Çdo ditë ka rëndësi, dhe çdo vonesë mund të ketë pasoja. Kujdesi ndaj vetes është akti më i fuqishëm që mund të bësh për jetën tënde.

Bëje kontrollin e gjirit pjesë të rutinës
tënde vjetore dhe inkurajo gratë
e tjera që të bëjnë të njëjtën
gjë.

Bashkohu me fushatën
Tetori Rozë në ALBSIG dhe
ndihmo në përhapjen e
mesazhit të kujdesit dhe
parandalimit.

ALBSIG!
Me ju dhe për
ju, në çdo hap
të rëndësishëm
jetësor.





 +355 (0) 42254770 / 764

 info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL